



## QENDRA PËR INFORMIM E KOSOVËS

### KOSOVA INFORMATION CENTER

FILLIM KATEGORITË OPINIONE EKSKLUZIVE GALERIA ARKIVI MARKETING KONTAKT

#### KATEGORITË

Kosovë  
Rajon  
Botë  
Ekonomi  
Kulturë  
Sport  
Komente  
Gjykimi në Hagë  
English

Madhësia:

**Reklamoni**  
biznesin tuaj  
këtu

vetëm në  
**Kosova.com**

#### Federata Botërore e Shoqatave të të Zhdukurve do të ndihmojë ndriçimin e fatit të të pagjeturve në Kosovë

Prishtinë, 24 nëntor - Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur znj. Jone Durgom Powers, kryetare e Federatës Botërore të Shoqatave të të Zhdukurve në Konfliktet e Armatosura. Qëllimi i takimit ishte koordinimi i aktiviteteve të mëtejme ndërmjet institucioneve qeveritare të Kosovës, asociacioneve të familjarëve të të pagjeturve dhe bashkësisë ndërkombëtare, për të hedhur dritë në fatin e personave të pagjetur. Znj. Jone Durgom Powers, e cila është duke mbledhur të dhëna nga familjarët e të pagjeturve, ka shprehur vendosmërinë e Federatës që e përfaqëson, të ndihmojë ndriçimin e fatit të të pagjeturve, sidomos në planin e ekspertizave nga profesionistë të mjekësisë ligjore.

Kryeparlamentari Berisha ka falënderuar për iniciativën dhe vullnetin e mirë, ndërsa ka shprehur gatishmërinë e Kuvendit të Kosovës të ofrojë gjithë bashkëpunimin e nevojshëm sa i përket kësaj çështjeje të ndjeshme në Kosovë. Ai ka pohuar se është bërë pak për zbardhjen e fatit të personave të pagjetur, kryesisht për shkak të kompetencave të mangëta të institucioneve tona në këtë fushë. Në këtë takim është biseduar edhe për iniciativat dhe procedurat që 27 prilli të shpallet Ditë e personave të pagjetur. Po ashtu edhe Ministri i Drejtësisë Jonuz Salihaj ka pritur në një takim znj. Jane Durgom - Powers, nënkryetare e Odës së Avokatëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe kryetare e Federatës Botërore e Shoqatave të të Zhdukurve . Në këtë takim u bisedua për çështjen e personave të zhdukur, kryesisht është folur për bashkëpunimin mes familjarëve të personave të pagjetur dhe Ministrisë së Drejtësisë. Ministri Salihaj premtoi se do të jetë një kooperim shumë i mirë mes Ministrisë së Drejtësisë dhe familjarëve të personave të pagjetur, edhe përkundër faktit se familjarët shprehin shqetësimin e tyre që qeveria nuk ka bërë mjaft për persona të zhdukur. Po ashtu Salihaj ka shprehur brengën për mungesë të ekspertëve mjeko ligjorë dhe të antropologëve. Ai kërkoi që një ekipe nga Kosova t'u mundësohet specializimi në Amerikë, për ekspertë mjeko ligjor dhe antropologë, në mënyrë që pasi të kthehen në Kosovë t'i kontribuojnë hulumtimit të të pagjeturve.

► [MË SHUMË LAJME NGA KOSOVA](#)



#### KËRKO

Shkruaj fjalën

- Kategoria -

KËRKO

Reklamoni  
biznesin  
tuaj këtu

Reklamoni  
biznesin  
tuaj këtu

Reklamoni  
biznesin  
tuaj këtu